

STRATEGJIA E KOMUNIKIMIT

2022-2025



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Tiranë, korrik 2022

Përmbajtja

1. Parimet e komunikimit të KLSH-së	4
2. Palët e interesit.....	5
3. Risi, fakte, analiza.....	7
4. Qëllimi i Përgjithshëm dhe Objektivat strategjike	11
5. Rolet dhe përgjegjësitë.....	13

FALENDERIME

Ky dokument u hartua me mbështetjen e SIGMA-s (iniciativë e përbashkët e OECD dhe BE), e cila është një partnere e qenësishme e Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe luan një rol të rëndësishëm duke dhënë kontribut të vyer në rritjen e kapaciteteve institucionale dhe profesionale të stafit të Kontrollit të Lartë të Shtetit nëpërmjet konsulencës dhe praktikave më të mira.

PARIMET E KOMUNIKIMIT TË KLSH-së

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH), në cilësinë e institucionit më të lartë kushtetues të kontrollit ekonomik e financiar në vend, ka si mision të tij të jetë “agjent” i Kuvendit dhe palëve të interesit duke i informuar në mënyrë të vazhdueshme, të paanshme dhe të plotë, mbi përgjegjshmërinë që qeveria dhe entet publike tregojnë në përdorimin e burimeve e fondeve publike me ekonomicitet, efektivitet dhe eficiencë.

KLSH, në vizionin e tij është një institucion model që udhëheq nëpërmjet shembullit, që nxit rritjen e përgjegjshmërisë, transparencës, duke forcuar integritetin dhe besimin e publikut tek institucioni, për të qenë vlerë e shtuar për shoqërinë dhe të sjellë ndryshim në jetën e qytetarëve. Kjo bazuar në vlera si: integriteti, pavarësia, objektiviteti, kompetenca, konfidencialiteti dhe transparenca.

KLSH e konsideron të rëndësishëm zhvillimin dhe zbatimin e Strategjisë së Komunikimit, si pjesë të domosdoshme për përmbushjen e misionit të tij dhe objektivave strategjikë të zhvillimit institucional bazuar në parimet e:

Gjithëpërfshirjes: Produktet e KLSH-së janë të destinuara për të gjithë qytetarët shqiptarë dhe palët e interesit. Ato janë të disponueshme në gjuhën zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

Transparencës: KLSH në zbatim të së drejtës për informim dhe parimeve të INTOSAI–P-20, komunikon në kohë dhe gjerësisht mbi aktivitetin e tij institucional dhe rezultatet e auditimit.

Qartësisë: KLSH komunikon mesazhin e saj në një mënyrë të kuptueshme, të përmbledhur dhe miqësore për përdoruesit.

Vërtetësisë: Produktet e KLSH-së janë rezultat i procesit të auditimit të kryer në mënyrë profesionale bazuar në standardet ndërkombëtare të auditimit dhe praktikat më të mira të fushës, bazuar në fakte dhe evidenca të plota auditimi, duke përfshirë sigurimin dhe kontrollin e duhur të cilësisë.

Inovacionit: KLSH inkurajon futjen e inovacionit në komunikim dhe në bashkëpunim me aktorë të ndryshëm kyç, me qëllim rritjen e interesit publik për punën e Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe ndikimin e auditimeve të tij.

Koherencës: Mesazhi i KLSH-së jepet brenda afateve të përcaktuara nga kuadri ligjor dhe i përgjigjet nevojave dhe interesave aktuale të publikut dhe palëve të interesit.

Aksesueshmërisë në informacion: KLSH ofron një akses të lehtë dhe të shpejtë në informacionin rreth punës së tij për palët e interesit duke përdorur kanale dhe mjete të ndryshme efektive komunikimi.

PALËT E INTERESIT

Palët e interesit kanë një rol të rëndësishëm për KLSH në përmbushjen e misionit kushtetues dhe ndërveprimi me ta sikurse edhe me partnerët strategjikë është synuar të jetë konstruktiv dhe dinamik.



Palët kryesore të interesit që kjo strategji komunikimi merr në konsideratë dhe i shërben janë:

Kuvendi i Shqipërisë

Parimet Themelore të vendosura në Deklaratën e Limës (ISSAI 1) dhe Deklaratën e Meksikos (ISSAI 10), kërkojnë që institucioni suprem i auditimit duhet të vendosë dhe të mbajë komunikim dhe marrëdhënie efektive me Parlamentin dhe komisionet përkatëse të tij.

Në mënyrë të veçantë, ISSAI 20, nënvizon se: *“Institucionet Supreme të Auditimit të mbajnë një marrëdhënie të fortë me komisionet përkatëse parlamentare për t’i ndihmuar ato të kuptojnë më mirë raportet dhe konkluzionet e auditimit dhe të ndërmarrin veprimet e duhura”*.

Mbështetur në këto parime, KLSH ka intensifikuar bashkëpunimin dhe bashkëveprimin me Kuvendin, veçanërisht me Komisionin e Ekonomisë dhe Financave për të rritur eficiencën e punës audituese dhe shkallën e zbatimit të rekomandimeve në mbështetje të qeverisjes së mirë, llogaridhënies dhe transparencës.

Qytetari shqiptar

Në funksion të misionit të tij, KLSH synon t’u shërbejë qytetarëve dhe taksapaguesve në mënyrë të drejtpërdrejtë, por edhe në mënyrë indirekte duke u siguruar mundësinë dhe aksesin e plotë për të kontribuar në realizimin e qëllimit të përbashkët, atë të mirëqeverisjes.

Qeveria dhe subjektet e audituara

Me synim mirëmenaxhimit të fondeve publike, KLSH bashkëpunon me Ministrinë e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, duke informuar në mënyrë të vazhdueshme qeverinë mbi rekomandimet e KLSH-së për institucionet qendrore dhe atyre të varësisë, me qëllim hartimin nga Këshilli i Ministrave të akteve që nxisin zbatimin e këtyre rekomandimeve.

Shoqëria civile

Organizatat jofitimprurëse (OJF), përfshirë dhe shoqatat profesionale janë një partner i vlefshëm për KLSH-në dhe vendosja e urave të komunikimit mbi baza të rregullta e të vazhdueshme, me qëllim ndërmarrjen e auditimeve që trajtojnë tematika me impakt shoqëror dhe që rrisin ndërgjegjësimin mbi problematikat me karakter social-shoqëror dhe ekonomik.

Media

Media si një mjet i komunikimit në masë, do të vazhdojë të jetë një partner i rëndësishëm strategjik i institucionit për pasqyrimin në kohë dhe promovimin e aktivitetit auditues të KLSH përfshirë këtu median e shkruar, audio-vizive dhe atë online.

Bota akademike

KLSH ka institucionalizuar dhe intensifikuar bashkëpunimin me institucionet akademike, veçanërisht me universitetet publike në Shqipëri, me synim promovimin e punës së audituesit të jashtëm publik, rritjen e kapaciteteve audituese dhe tërheqjen e audituesve të rinj.


INTOSAI, EUROSAT dhe SAI-t homologe

KLSH është anëtar i Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI) që nga viti 1984 dhe gjithashtu, që prej vitit 1993, KLSH është anëtar i Organizatës Evropiane të Institucioneve Supreme të Auditimit (EUROSAT).

Bashkëpunimi në mjedisin e INTOSAI-t dhe EUROSAT-t, por edhe në nivel bilateral me SAI-t homologe, ka si qëllim intensifikimin e bashkëpunimit për fusha me interes të ndërsjellë, të cilat janë fokusuar në kryerjen e auditimeve të koordinuara ose paralele, shkëmbimin e eksperiencës dhe ekspertizës për çështje të caktuara, si dhe ngritjen e kapaciteteve institucionale dhe profesionale të stafit të KLSH-së.

RISI, FAKTE, ANALIZA

KLSH ndjek një model komunikimi dykahësh, duke identifikuar qartë se komunikimi i institucionit bëhet më interaktiv ndërmjet palëve të jashtme të interesit dhe qytetarit në veçanti dhe KLSH-së.



Bazuar në këtë model, për të mbështetur hartimin e kësaj strategjie, u krye një sondazh në muajin Mars 2022, i dedikuar posaçërisht për palët e interesit si: subjektet e audituara, media, organizatat e Shoqërisë Civile, universitetet etj., si edhe të audituesve të KLSH.

Nëpërmjet sondazhit u synua marrja e perceptimit të palëve të interesit për aktivitetin e KLSH-së dhe rolin që luan në mirëqeverisje, si një informacion i vlefshëm për zhvillimin e komunikimit dhe prioritetet strategjike të reja. Nga sondazhi mbi perceptimin e palëve të interesit për aktivitetin e KLSH-së rezultoi se:

- **Për sa i përket statusit të KLSH-së**, me subjektet e audituara dhe palët e jashtme të interesit, ku këto të fundit janë më pak pozitive, në përgjithësi sondazhet tregojnë se KLSH shihet si një institucion profesional dhe i respektuar, që demonstroi pavarësi dhe integritet dhe gjithashtu si një burim i besueshëm informacioni të pavarur. Megjithatë, nga shumica e palëve të jashtme të interesit, roli kryesor i KLSH-së perceptohet ai i një institucioni ligjzbatues, që trajton çështjet e korrupsionit dhe të mashtrimit, më shumë sesa një institucion, që i shërben Parlamentit, për t'i kërkuar Qeverisë të jetë e përgjegjshme në kryerjen e veprimtarisë së saj.
- **Në lidhje me ndikimin dhe rëndësinë e KLSH-së**, sondazhet tregojnë se KLSH-ja si institucion në përgjithësi promovon një kulturë transparence dhe llogaridhënieje në të gjithë sektorin publik, megjithëse një përqindje e aktorëve të jashtëm nuk janë dakord. Ka një dakordësi të përgjithshme në të dy grupet që raportet e KLSH-së janë relevante dhe efektive për të realizuar llogaridhënien e ekzekutivit dhe të dobishme për përmirësimin e jetës së qytetarëve.

- **Në lidhje me cilësinë e raportimit të KLSH –së,** sondazhi tregon se subjektet e audituara vlerësojnë se KLSH-ja në përgjithësi harton raporte me cilësi të mirë që shihen si të sakta dhe të besueshme, dhe janë gjerësisht të kuptueshme, të paraqitura mirë dhe me rekomandime të qarta. Megjithatë, palët e jashtme të interesit janë më pak pozitive me një përqindje të vogël që nuk janë dakord se ato janë të kuptueshme, të paraqitura mirë apo me rekomandime të qarta.
- **Në lidhje me komunikimin me palët e interesit,** sondazhet paraqesin një tablo më të përzier ku përgjigjet e subjekteve të audituara janë më pozitive se tabloja e paraqitur nga anketa e palëve të jashtme të interesit. Kjo veçanërisht në lidhje me sa proaktive është KLSH-ja në lidhje me komunikimin e saj dhe sa efektiv është komunikimi.

Gjithashtu, Programi i Zhvillimit i OKB-së dhe Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim kanë zhvilluar gjatë vitit 2020 sondazhin e opinionit publik *“Besimi në Qeverisje”*¹, i cili që bën të mundur monitorimin e përvitshëm të besimit dhe perceptimit të publikut për qeverisjen. Në këtë sondazh vlerësohet se qytetarët e anketuar priren të besojnë se mekanizmi më efikas i llogaridhënies në vend është Kontrolli i Lartë i Shtetit me 60.7%, i ndjekur nga media (52.8%), Parlamenti (48.1%), shoqëria civile (44.8) dhe Avokati i Popullit (44.3%).

Në kuadër të Strategjisë së Zhvillimit Strategjik, KLSH ka forcuar dhe ka zhvilluar bashkëpunimin me palë të ndryshme të interesit, bashkëpunime të cilat pritet të japin edhe rezultate konkrete në të ardhmen si:

Bashkëpunimi i KLSH-së me Iniciativën për Zhvillim të INTOSAI-t (IDI): për angazhimin në iniciativën *“Strategjia, Matja e Performancës dhe Raportimi (SPMR)”* në kuadër të së cilës KLSH ka kryer vetëvlerësimin e performancës së institucionit duke përdorur Metodologjinë e Kornizës së Matjes së Performancës së INTOSAI-t, dhe do të hartojë Strategjinë e re të Zhvillimit të institucionit 2023-2028.

Bashkëpunimi me EUROSAT: si anëtar i Grupit të Punës për Auditimet e Mjedisit për kryerjen e auditimit paralel me temë “Mbetjet plastike”; anëtar i Grupit për vetëvlerësimin IT, ku KLSH është vetëofruar për kryerjen e vetëvlerësimit të infrastrukturës IT në tetor 2022 si dhe është pjesë e auditimit paralel me temë “Të ardhurat nga taksat dhe tarifat e bashkive për të siguruar shërbime cilësore për qytetarët gjatë pandemisë”, i cili do të kryhet në bashkëpunim me institucionet supreme të auditimit të Maqedonisë së Veriut, Malit të Zi, Polonisë, Rumanisë, Turqisë dhe Sllovakisë.

Bashkëpunimi me SAI-t homologe, KLSH ka nënshkruar ndër vite 18 marrëveshje bashkëpunimi, të cilat kanë në fokus shkëmbimin e eksperiencave për çështje të caktuara me interes të përbashkët. Në maj 2022, KLSH ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me

¹ https://www.al.undp.org/content/albania/en/home/library/democratic_governance/trust-in-governance-opinion-poll-2020.html

Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm të Norvegjisë, e cila ka si qëllim vendosjen e bashkëpunimit në shkallë të gjerë, për auditimet e performancës në fushën e mjedisit dhe në auditimet IT.

KLSH vijon **bashkëpunimin me SIGMA-n** si një nga partnerët kryesorë dhe më të rëndësishmit, kjo jo vetëm për kontributin në monitorimin dhe vlerësimin periodik të aktivitetit të KLSH-së që prej vitit 2000, por edhe për mbështetjen e qenësishme që ka dhënë në rritjen e kapaciteteve audituese dhe së fundmi me asistencën në hartimin e kësaj strategjie komunikimi si edhe për konceptimin e Manualit për Auditimin e Zbatimit të Buxhetit.

Bashkëpunimi i KLSH-së me Prezencën e OSBE-së në Tiranë dhe Autoritetin Kombëtar Italian Kundër Korrupsionit (ANAC) ka qenë i frytshëm mes palëve për përmirësimin e punës audituese të KLSH-së me fokus prokurimin publik duke nënvizuar se transparenca dhe dixhitalizimi do të jenë mënyrat për të parandaluar korrupsionin dhe për të siguruar një administratë publike më të mirë.

Bashkëpunimi i KLSH-së me Ambasadën Zvicerane, në kuadër të marrëveshjes së nënshkruar për financimin nga Sekretariati i Çështjeve Ekonomike të Zvicrës (SECO) të projektit *“Forcimi i mbikëqyrjes së kontratave të koncesionit dhe partneritetit publik privat në Shqipëri”*, do të kryen auditime pilot si dhe do të hartohet një udhëzues për auditimin e kontratave koncesionare dhe PPP.

Bashkëpunimi i KLSH-së me UN Women në kuadër të marrëveshjes së nënshkruar në vitin 2021, do të mundësojë zhvillimin e kapaciteteve të audituesve, si dhe do të japë mbështetje teknike në procesin e zhvillimit të metodologjisë së auditimit gjinor.

Analiza SWOT

Strategjia e Komunikimit është bazuar në një analizë SWOT², e cila është një model i aplikuar në fushën e menaxhimit strategjik dhe jep qartë një pasqyrë të strukturuar të pikave të forta, dobësive, mundësive dhe kërcënimeve ndaj institucionit.

Faktorët e brendshëm siç janë pikat e forta dhe të dobëta mund të kontrollohen dhe ndryshohen nga një SAI, ndërsa faktorët e jashtëm siç janë mundësitë dhe kërcënimet, janë kryesisht të orientuara nga politika, media, parlamenti, organet legislative, qeveritë dhe subjektet audituese. Ndërlidhja e pikave të forta dhe mundësive ose dobësive dhe kërcënimeve të identifikuar, tregojnë bazat e rëndësishme për një plan dhe strategji komunikimi gjithëpërfshirës në të ardhmen dhe marrjen e masave të duhura.

Pas një analize të mirëfilltë të aktiviteteve të kryera në bazë të Strategjisë së mëparshme të komunikimit 2017-2019, si dhe rezultateve të sondazheve të kryera, KLSH ka identifikuar nëpërmjet një analize SWOT tiparet e mëposhtme:

² S-Strengths-Pikat e forta, W-Weaknesses-Dobësitë, O-Opportunities-Mundësitë, T-Threats-Kërcënimet



Rezultatet e kësaj analize nxjerrin në pah nevojën e promovimit të rolit të KLSH duke filluar me qartësimin e mandatit që institucioni ka dhe vendi që zë në sistemin publik, pritshmëritë e palëve të interesit në funksion të rritjes së impaktit të punës audituese në mirëqeverisje dhe besimit tek institucionet publike në tërësi.

QËLLIMI I PËRGJITHSHËM

Komunikimi është një sfidë gjithnjë në rritje për institucionet publike, të cilat duhet të përshtaten vazhdimisht me mjedisin e komunikimit që evoluon shpejt.

KLSH është i vetëdijshëm se komunikimi nuk ka të bëjë vetëm me ofrimin e informacionit, por është gjithashtu një proces i dyanshëm. Pra, përveç komunikimit të rezultateve të punës, gjetjeve të auditimit, KLSH mban kanale të hapura për palët e ndryshme të interesit dhe veçanërisht opinionin publik, për të marrë në mënyrë aktive komentet dhe sugjerimet tyre për vazhdimësinë e aktivitetit auditues, në mënyrë që t'i përgjigjet më mirë publikut dhe sfidave që kërkojnë angazhimin e dedikuar të KLSH-së si një institucion suprem i auditimit transparent dhe i aksesueshëm, parakushte këto themelore që qytetarët të fitojnë besimin në punën e tij.

Prandaj, në kuadrin e forcimit të mëtejshëm të transparencës dhe llogaridhënies qëllimi i përgjithshëm i këtij dokumenti strategjik është të ndërtojë besimin e aktorëve kryesorë në punën e KLSH-së si një burim informacioni të pavarur, të vërtetë dhe të paanshëm politikisht, si dhe për të rritur dukshmërinë dhe për të maksimizuar shpërndarjen, kuptimin dhe impaktin e raporteve të auditimit nga të gjitha palët e interesuara.

Arritja e këtij qëllimi, nënkupton zbatimin e katër objektivave strategjikë specifikë dhe të një numri aktiviteteve që do të kontribuojnë në realizimin e këtyre objektivave.

OBJEKTIVAT STRATEGJIKË TË KOMUNIKIMIT

Objektivat strategjikë të komunikimit të KLSH-së janë përcaktuar në bazë të nevojave, kërkesave dhe sfidave të institucionit në komunikimin me palët e jashtme të interesit, por edhe në bazë të komunikimit dhe angazhimit të stafit të brendshëm nëpërmjet anketimit, burimeve aktuale njerëzore dhe financiare, si dhe mundësisë së kufizuar të rritjes së tyre për periudhën e realizimit të Strategjisë.

Objektivi Nr. 1: Promovimi i rolit dhe mandatit të KLSH nëpërmjet shtimit të mjeteve të komunikimit me palët e interesit, me qëllim forcimin e besimit tek institucioni i auditimit të jashtëm publik

Kjo përbën një sfidë për KLSH-në, në rolin e vet promovues dhe stimulues në drejtim të rritjes së përgjegjshmërisë dhe transparencës në përdorimin e fondeve dhe pronës publike nëpërmjet raporteve të pavarura, të paanshme, objektive dhe profesionale. KLSH do të vijojë të informojë Parlamentin për gjendjen e financave publike në mënyrë që të minimizohet keqpërdorimi i fondeve publike dhe t'iu vijë në ndihmë institucioneve ligjzbatuese, të cilat fokusohen në luftën kundër korrupsionit.

KLSH synon të shpjegojë rolin e tij në të gjitha nivelet e qeverisjes, në shoqëri dhe në media. Për KLSH-në është thelbësore që mesazhi i auditimit të përcillet deri tek qytetari i thjeshtë dhe për këtë do të sigurojë aksesimin e tij nëpërmjet burimeve të brendshme të komunikimit, bashkëpunimit me median si edhe mjete të tjera të komunikimit.


Objektivi Nr. 2: Rritja e impaktit të veprimtarisë audituese të KLSH-së nëpërmjet raporteve cilësore, relevante dhe të qarta në funksion të llogaridhënies dhe transparencës

KLSH synon të rrisë impaktin e veprimtarisë audituese duke u fokusuar tek: cilësia e produkteve të auditimit; relevanca e tyre për të dhënë informacion të dobishëm për çështje të interesit publik; paanshmëria, me synim dhënien e rekomandimeve objektive dhe të qëndrueshme.

Me qëllim maksimizimin e të të kuptuarit të raporteve të auditimit, KLSH nëpërmjet kësaj Strategjie do të synojë hartimin e raporteve konçize dhe në gjuhë të thjeshtë, për t'i bërë ato më të kuptueshme për të gjitha palët e interesit, duke përfshirë dhënien e rekomandimeve të qarta dhe të orientuara drejt veprimeve korrigjuese dhe konkrete.

Objektivi nr. 3: Intensifikimi i ndërveprimit me Kuvendin e Shqipërisë për rritjen e kontrollit parlamentar ndaj institucioneve publike për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së me qëllim rritjen e efektivitetit të sistemit të auditimit të jashtëm

KLSH do të synojë intensifikimin e bashkëpunimit me Kuvendin e Shqipërisë si një prej tre komponentëve kryesor të trekëndëshit të llogaridhënies për të ushtruar mbikqyrjen parlamentare me qëllim rritjen e mirëpërdorimit të parasë publike nga të gjitha organet e qeverisjes. KLSH në marrëdhënien me Parlamentin do të vijojë të përmbushë përcaktimet e ISSAI 12 i cili përcakton zhvillimin e bashkëpunimit me komisionet parlamentare për t'i



ndihmuar ata të kuptojnë më mirë raportet dhe konkluzionet e auditimit, në mënyrë që t'i ndihmojnë në vendimmarrjet e duhura.

Mbështetur në praktikat më të mira, konkluzionet dhe rekomandimet e dala nga dokumente vlerësuese të institucioneve ndërkombëtare, KLSH do të vijojë të theksojë rëndësinë e organizimit të dëgjësave nga Komisionet përkatëse parlamentare me subjektet e audituara me

qëllim ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve dhe rritjen e impaktit të raportit të auditimit të KLSH-së.

Objektivi Nr. 4: Rritja e komunikimit me subjektet e audituara dhe konsultimit me qytetarët, median, shoqërinë civile, botën akademike dhe partnerët ndërkombëtarë

Për KLSH-në është i qenësishëm komunikimi dhe konsultimi me të gjitha palët e interesit, me qëllim identifikimin e çështjeve me interes publik të përbashkët. Strategjia e komunikimit përcakton filozofinë e KLSH-së për angazhimin me palët e interesuara, në veçanti që të audituarit duhet të konsiderohen si partnerë dhe jo si kundërshtarë.

Media: Duke e konsideruar median si një nga bashkëpunëtorët më të rëndësishëm për promovimin e rolit dhe impaktin e veprimtarisë audituese, KLSH do të vijojë të ketë një komunikim efektiv me profesionistët e kësaj fushe, për t'i përcjellë publikut informacion në kohë dhe mesazh të qartë auditimi. Krahas medias tradicionale, KLSH synon përdorimin e platformave të reja të komunikimit, për të siguruar akses në informacion për çdo përdorues.

Qytetarët: KLSH është shndërruar tashmë në një institucion që “sheh” dhe “dëgjon” me vëmendje çdo ankesë, kërkesë apo denoncim që adresohet nga qytetarët përmes të gjitha kanaleve zyrtare të komunikimit, duke u siguruar mundësinë dhe aksesin e plotë për të kontribuar në realizimin e qëllimit të përbashkët, atë të mirëqeverisjes.

Shoqëria civile: KLSH synon intensifikimin e bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile për identifikimin e fushave dhe çështjeve relevante për auditim.

Bota akademike: Krahas pjesëmarrjes në konferenca dhe simpoziume shkencore që adresojnë çështje të menaxhimit të financave publike, përmes kësaj strategjie synohet rritja e bashkëpunimit me botën akademike për njohjen dhe promovimin e rolit dhe punës së KLSH-së tek profesionistët e ardhshëm.

Partnerët ndërkombëtarë (INTOSAI, EUROSAT dhe institucione të tjera ndërkombëtare), me të cilët do të vijojë bashkëpunimi me synim përfundimtar të eksperiencave më të mira ndërkombëtare për përmirësimin e metodologjisë së auditimit.

ROLET DHE PËRGJEGJËSITË

Kjo Strategji e Komunikimit është e rëndësishme për çdo anëtar të stafit të KLSH-së, i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë luan një rol në përcjelljen e mesazheve kyçe tek palët e interesit.

- Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe niveli i lartë drejtues luajnë një rol kyç në zbatimin e Strategjisë së Komunikimit përmes përcjelljes së mesazheve tek palët e interesit për çështjet që dalin nga puna e auditimit me qëllim rritjen e besimit të institucioni;
- Këshilltar për Media dhe Sektori i Komunikimit, Botimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë janë të ngarkuar për përcjelljen në kohë, në mënyrë efektive dhe profesionale të mesazheve të KLSH-së palëve të interesuara nëpërmjet:

Këshillimit se si të arrihet më së miri audienca e synuar, duke specifikuar formën dhe stilin e mesazhit dhe duke zgjedhur kanalin/-et dhe kohën më të përshtatshme;

Menaxhimit të marrëdhënieve publike të KLSH-së me median, Organizatat e shoqërisë civile, etj., përmes faqes së internetit të KLSH-së dhe kanaleve të tjera duke siguruar konsistencën e mesazhit;

Mirëmbajtjes dhe përditësimi i mjeteve të komunikimit të KLSH-së, duke përfshirë faqen e internetit, intranetin në bashkëpunim me Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit;

- Përgjegjësitë kryesore të stafit të auditimit në lidhje me komunikimin janë:

Kuptimi i misionit, vizionit dhe vlerave të KLSH-së dhe demonstrimi i tyre në hartimin e raporteve cilësore, profesionale, të paanshme, objektive dhe të kuptueshme nga të gjitha palët e interesit;

Bashkërendimi dhe bashkëpunimi i të gjitha strukturave në KLSH për hartimin e mesazheve të qarta të auditimit dhe një komunikim cilësor të veprimtarisë së institucionit tek subjektet e audituara.

Për të arritur qëllimet dhe objektivat e kësaj Strategjie të Komunikimit, KLSH do të hartojë një plan të detajuar të veprimit për vitet 2022-2025. Në të cilin do të përcaktohen qartë masat që do të ndërmerren për implementimin e objektivave, strukturat përgjegjëse, afatet për implementimin e këtyre masave dhe treguesit e progresit.

Struktura përgjegjëse për monitorimin, zbatimin, vlerësimin dhe që do të raportojë në mënyrë periodike tek Sekretari i Përgjithshëm, është Sektori i Komunikimit, Botimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

Sektori do t'i sigurojë nivelit drejtues të KLSH-së informacionin e nevojshëm në lidhje me statusin e zbatimit të Strategjisë, devijimin nga afati kohor i planifikuar dhe propozimin për ndryshimin e kornizës kohore ose të aktiviteteve që nuk janë zbatuar siç është planifikuar, duke specifikuar arsyet e moszbatimit.

Vendimmarrja dhe qasjet strategjike për zbatimin e objektivave të Strategjisë së Komunikimit do të zhvillohen në nivelin e menaxhimit të KLSH-së. Një pjesë e aktiviteteve do të koordinohen me departamentet përkatëse brenda KLSH-së, pasi ato përfshijnë aktivitete që kanë nevojë për inpute profesionale dhe teknike në mënyrë që të shtojnë vlerën informative të aktivitetit të KLSH-së.